

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 12.09.2024*

**12.09.2024  
Ora 10:34**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, zotit Vangjel Llambi Tavo, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.
- Parti Politike:** S’ka prezent
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Mirëmëngjesi! Në seancën e sotme publike kemi në rendin e ditës shqyrtimin e projektvendimit që ka të bëjë me dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, zotit Vangjel Llambi Tavo, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

Po Pavlina!

**Znj. P. Doçaj:** Faleminderit! Në mbështetje të Dekretit nr. 244, datë 05.07.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, “Për caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë”, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme të datës 4 Gusht 2024. Bazuar në nenin 33, shkronja “g”, Komisioni i

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 12.09.2024*

Zonës së Administrimit Zgjedhor të Bashkisë Himarë me përfundimin e procesit zgjedhor ka vendosur miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve, duke shpallur fitues kryetarin e Bashkisë Himarë që është zoti Vangjel Llambi Tavo, sipas këtij vendimi. Në datë 09.08.2024 është depozituar një kërkesë ankimore në KAS, nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ku kanë kërkuar “Kundërshtimin e vendimit të KZAZ-së “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse”, si dhe “Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha QV e kësaj zone zgjedhore”. Pas shqyrtimit të ankimit, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KZAZ dhe rrëzimin e kërkesës ankimore të depozituar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Në datë 03.09.2024 po ky subjekt zgjedhor, ky koalicion i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor me të njejtën kërkesë. Kolegji Zgjedhor në datën 09.09.2024 vendosi unanimisht, rrëzimin e kërkesës së palës paditëse dhe ka lënë në fuqi vendimin e KZAZ-së dhe KAS-it. Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse, sipas tabelës së rezultatit të vendosur nga KZAZ dhe shpalljes së fituesit nga kjo zonë zgjedhore. Bashkëlidhur keni edhe projektvendimin përkatës.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëhere, për sa u relatua, bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, neni 33, shkronja “g” dhe nenin 166, të “Kodi Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendos:

- Dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë, zotit Vangjel Llambi Tavo, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 12.09.2024*

Sanksioneve, brenda tre ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Çështje të tjera nuk kemi në rend dite, seanca mbyllet. Faleminderit!

---

**Vendimi nr. 177**

---

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

